



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1584/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Ujësjiellit Prishtina Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit L.L., me seli në Prishtinë, rr. “Kulla”, nr.6/9, me bazë juridike përmbarimore për borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1049/22, të datës 20.09.2023, me datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Regjionale e Ujësjiellit Prishtina Sh.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1049/22, të datës 20.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1049/22, të datës 20.09.2023, ka vendosur si në dispozitiv duke e aprovuar prapësimin e debitorit L.L., ashtu që shfuqizohet Urdhri për përmbarim P.nr.103/21 i datës 04.02.2021 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë shfuqizohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të pranohet si e bazuar ankesa e parashtruar, ashtu që të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi Urdhëri për Përmbarim P.nr.103/21 i datës 04.02.2021.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale e Ujësjellësit Prishtina Sh.A., me datë 04.02.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit L.L., në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit nga librat e kontabiliteti me shifër 122444, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori t'ia paguajë shumën prej 756.08 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.103/21 i datës 04.02.2021, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim, duke kundërshtuar urdhrin e përmbartuesit privat duke theksuar se lokali ku janë kalkuluar shpenzimet e ujit është shitur në muajin shkurt 2019, ashtu që shpenzimet pas kësaj date i takojnë blerësit F.Sh. dhe se ky borxh nuk qëndron fare dhe është paushall ngase nuk është lexuar ujëmatësi asnjëherë, andaj ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin dhe urdhëri përmbartimor të anulohet.

Kreditori brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, ku i ka propozuar gjykatës që prapësimin ta refuzojë si të pabazuar dhe urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.103/21 i datës 04.02.2021 ta lë në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1049/22, të datës 20.09.2023 me të cilin ka vendosur si në dispozitiv duke e aprovuar prapësimin e debitorit L.L., ashtu që shfuqizohet Urdhri për përmbartim P.nr.103/21 i datës 04.02.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë shfuqizohet, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim është i bazuar, dhe me këtë ka konstatuar me nenin 38 para. 1 dhe 2 të LPP-së parashihet se “ *Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit*” në para. 2 përcaktohet “Në

rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënime të kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të vepron sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”. Pra urdhëri përmbarrimor është në kundërshtim me këto dispozita e cekura më lartë, për arsye se propozimit për përmbarrim nuk është paraqitur të dhënat e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, duke mos treguar saktë emrin e debitorit dhe të dhënat të tjera për identifikimin e debitorit. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me nenin 43 para. 4 të LPP-së përcaktohet se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.”.* pra edhe me këtë dispozita gjykata ka konstatuar se nuk ka të dhënat e nevojshme që në rastin konkret urdhëri mbi lejimin e përmbarrimit është dashur të nxjerrët për identifikimin e saktë të debitorit. Gjithashtu sipas nenin 29 pika 1.2 të LPP-së ekstrakti që është përcaktuar si dokument përmbarrimi nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitorit.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin e papësimit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i atakuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore sipas pretendimeve ankimore të kreditorit përmes ankesës së paraqitur.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përmbarrimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të

cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbare pa specifikuar shkeljet e pretenduara, për Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë është pretendim i pabazuar, për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se “ *Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se më këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër* ”. Në kuptim të kësaj dispozite nënkuptojmë se organi përmbareues duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbareues, ndërsa me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit, gjykata është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së, dhe se arsyetimi i gjykatës si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar në këtë fazë të procedurës, është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e LPP-së.

Me nenin 29 paragrafi pika 1.2 e LPP-së, përcaktohet se: “ *Përmbareimi me qëllim të realizimit të kërkesës në to holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ... ekstraktet e verifikuara nga librat afariste* ”. Në këtë rast në shkresat e lëndës si provë materiale përveç tjerash gjendet ekstrakti i verifikuar nga librat afariste Ekstraktit nga librat e kontabiliteti me shifër 122444. Mirëpo në këtë rast nga shikimi i ekstraktit lidhur me identifikimin e debitorit rezulton se shuma e kërkuar është për periudhë kohore 01.01.2013 e deri me 29.01.2021, mirëpo në ekstrakt nuk është pasqyruar saktë rrjedha e borxhit në rubrikën “Saldo”, figuron borxhi para datës 01.01.2013, në lartës prej 376.85 euro, ndërsa në ekstrakt nuk është treguar periudha kohore për të cilën është krijuar ky borxh fillestar dhe rrjedhimisht nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri të borxhi kryesor i cili tani kërkohet nga kreditori për përmbushje. Prandaj ekstrakti mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm, ashtu që rezultojnë si të pa themelta pretendimet ankimore në këtë drejtim. Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë ka vlerësuar drejt mënyrën e vendosjes edhe sa i përket konstatimi nga neni 38 para. 1 dhe 2 të LPP-së ku parashihet se “ *Propozimi për përmbareim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbareim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbareimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbareimi, kërkuesi i përmbareimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbareimi, objekti i përmbareimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbareimit* ” në para. 2 përcaktohet “ *Në rast se propozimi për përmbareim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbareues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore* ”. Pra urdhëri përmbareimor është në kundërshtim me këto dispozita e cekura më lartë, për arsye se propozimit për përmbareim

nuk është paraqitur të dhënat e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit., duke mos treguar saktë emrin e debitorit dhe të dhënat të tjera për identifikimin e debitorit.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, se me rastin e pranimin të të prapësimit të palës debitorë, të paraqitur kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, P.nr.103/21 i datës 04.02.2021, sepse gjykata i ka vlerësuar rrethanat e lartcekura në kuadër të provave që i ka pasur në dispozicion në momentin e vendosjes sipas prapësimit.

Gjykata Komerciale me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles se Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1584/23, dt. 01.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami